



MuKi-Deutsch

ICH LERNE DEUTSCH - MEIN KIND AUCH

Albanisch

UNE MESOJ GJERMANISHT, FEMIJA IM

Të dashura nëna, nëse ende e flisni shumë pak gjermanishten apo nuk e dini fare dhe nëse keni fëmijë të moshës që ende nuk e kanë vizituar kopshtin, atëherë ky është një kurs i gjuhës për ju.

Pse duhet të mësoj gjermanisht?

Sepse duke mësuar gjermanisht mësoni shumë për jetën dhe shkollën në Zvicër. Sepse ju në një grup me nënat e tjera dhe me mësuesen mund të shkëmbeni mendime për edukimin dhe çështjet e tjera të përditshme. Sepse ju mund ta përkrahni me mirë fëmijën tuaj kur të shkojë në kopsht apo në shkollë. Sepse më vonë mund të bisedoni me mësuesen apo mësuesin e fëmijës suaj dhe mund të merrni pjesë në mbrëmjet e prindërve. Sepse ju jeni shëmbëlltyrë për fëmijën tuaj sa i përket të mësuarit gjermanisht.

IA mund ta vizitoj MuKi - kursin e gjermanishtes nëse nuk di të shkruaj dhe të lexoj?

Jo. Ju duhet të dini shkrim e lexim.

Në cilën moshë duhet të jenë fëmijët për të vizituar një MuKi - kurs të gjermanishtes?

Normalisht mes moshës 0-6 vjeç.

Pse janë të mira MuKi - kurset e gjermanishtes për fëmijët?

Sepse fëmijët mësojnë të luajnë dhe sajojnë bashkë me fëmijët e tjerë. Sepse ata dëgjojnë tregime dhe njihen me këngë të shkurtra dhe rimën e tyre. Sepse ata mësojnë se si funksionon loja grupore (Spielgruppe) në Zvicër. Mbi të gjitha, sepse fëmijët mësojnë gjermanisht. Ata mësohen ta kuptojnë gjermanishten dhe varësisht nga moshja mësojnë shumë fjalë. Kur ta vizitojnë kopshtin ky kurs ju ndihmon atyre shumë. Ata përparojnë më shpejtë në të mësuarit e mëtutjeshëm të gjermanishtes.

Kush i mban kurset?

Udhëheqëse të kursit janë mësueset dhe udhëheqëset e lojës grupore (Spielgruppe), që kanë përvojë në dhënien e mësimit të gjuhës gjermane si gjuhë e dytë.

Si është i organizuar një MuKi- kurs i gjermanishtes?

Kursi fillon pas pushimeve të verës dhe zgjatë deri në përfundim të vitit shkollor, pra afërsisht 12 muaj. Ju do të mësoni gjermanisht dy orë gjatë javës. Materialin mësimor do ta merrni në kurs. Paralelisht me këtë fëmijët do të mbikëqyren nga dy persona të specializuar dhe 2 orë rresht do të mësojnë gjermanisht në lojën grupore (Spielgruppe).

Sa është kapaciteti i kurseve?

6-12 gra për kursin e nënave, 6-12 fëmijë për kursin e fëmijëve.

Si dhe deri kur mund të regjistrohem në një kurs?

Plotësojeni formularin e paraqitjes dhe dërgojeni në adresën e shënuar në pjesën e prapme të talonit për paraqitje. Luteni ta ngjitni pullën postare në kartolinë! Nëse ka ende vende të lira është e mundur pjesëmarrja në një kurs aktual.

Sa kushton një MuKi- kurs i gjermanishtes?

Shpenzimet e kursit janë për ju dhe për fëmijën gjithsej 240 franga. Ju e paguani kursin në fillim të kursit me një çek dhe pastaj do të merrni një vërtetim

A jam unë apo fëmija im gjatë kursit të siguar?

Jo. Ju duhet ta keni një sigurim privat ndaj aksidentit dhe sigurimin për dëmshpërblim /zhdëmtim (Haftpflicht).

Ku mund të marr edhe më shumë informacione?

Sekretariat Schule Niederbipp, Zollwegli 10, 4704 Niederbipp, Tel. 032 633 26 86, [bildungsekretariat@schule-niederbipp.ch](mailto:bildungssekretariat@schule-niederbipp.ch)

